

A photograph of a woman wearing a dark hijab and a maroon embroidered shirt, smiling warmly. A young child in a white embroidered dress is leaning on her shoulder. They are on a red playground structure. The background is slightly blurred, showing other people and a building.

NAFO

Nasjonalt senter for flerkulturell oppl ring

F MIJ T N  FAMILJE SHUM GJUH SHE

FLET  INFORMACIONI
Albansk

PARATHËNIE

Kjo broshurë informacioni merret me 10 pyetje që prindërit shpesh bëjnë në lidhje me zhvillimin shumëgjuhësor të fëmijëve. Broshura i drejtohet edhe personelit në kopshte, shkolla dhe qendra shëndetësore, dhe ajo mund të përdoret si pikënisje për një bisedë me prindërit rreth zhvillimit shumëgjuhësor të fëmijës.

Fleta e informacioni bazohet në broshurën suedeze Dy gjuhë ose më shumë – Këshilla për familjet shumëgjuhëshe, të prodhuar nga Instituti i Kërkimeve Gjuhësore në Rinkeby (<http://modersmal.skolverket.se/>) dhe është një botim i rishikuar. Kjo broshurë është ripunuar dhe përshtatet me situatën e fëmijëve shumëgjuhësh në kopshtet dhe shkollat Norvegjeze.

RRETH SHUMËGJUHËSISË

Shumica e shoqërive në botë janë shumëgjuhëshe. Zotërimi i disa gjuhëve është një aftësi e vlefshme si për individin edhe shoqërinë. Gjuha është e lidhur ngushtë me identitetin, socializimin dhe shprehjen kulturore dhe për këtë arsye është një pjesë e rëndësishme e fëmijës dhe e jetës së të rriturve.

Shumëgjuhësia sjell aq të mira, saqë shumica e familjeve që kanë dy ose më shumë gjuhë, nuk mund të imagjinojnë të mos i kenë ato. Zhvillimi shumëgjuhësor i fëmijës përforcohet në qoftë se kopshti dhe shkolla kanë një qëndrim pozitiv ndaj shumëgjuhësisë.

Familjet shumëgjuhëshe janë unike

Familjet mund të jenë dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe në shumë mënyra të ndryshme.

- Gjuha amtare e një ose të dy prindërve nuk është Norvegjeze.
- Prindërit kanë gjuhë të ndryshme amtare dhe fëmija dëgjon dy ose më shumë gjuhë në shtëpi që nga fillimi.
- Një ose të dy prindërit janë rritur në një vend ku gjuhë të ndryshme janë folur në shtëpi dhe në shkollë.

Ashtu si edhe prindërit, shumë familje kanë të afërm të cilët luajnë një rol aktiv në jetën e përditshme të fëmijëve dhe u japin fëmijëve qasje në disa gjuhë.



1 A ËSHTË E MUNDUR QË NJË FËMIJË TË MËSOJË DISA GJUHË NJËKOHËSISHT?

Fëmijët mund të mësojnë disa gjuhë në të njëjtën kohë. Në pjesë të mëdha të botës, është e zakonshme që fëmijët të mësojnë disa gjuhë që kur ata janë shumë të vegjël. Që fëmija të zhvillojë disa gjuhë në nivel të kënaqshëm, shtëpia, çerdhja dhe shkolla duhet të ndihmojnë në mënyrë aktive. Është e rëndësishme që mjedisi rrethues i fëmijës të inkurajojë dhe të mbështesë zhvillimin shumëgjuhësor të fëmijës.

Familjet me një formim kulturor prej pakicash mundet fare mirë të mbajnë kontaktet me të afërmit dhe miqtë në vende të tjera në qoftë se ata ruajnë gjuhën amtare. Fëmijët nga këto familje kanë një mundësi më të madhe të pjesëmarrjes në trashëgiminë kulturore të prindërve nëse ata zotërojnë gjuhën e prindërve. Kjo përforcon identitetin dhe ndjenjën e përkatësisë të fëmijëve.

2 A DO TË MËSOJË NJË FËMIJË NORVEGJISHT, NËSE PRINDËRIT FLASIN GJUHËN E TYRE AMTARE NË SHTËPI?

Fëmija ka kushte më të mira për të mësuar një gjuhë të dytë në qoftë se ata kanë një gjuhë amtare të zhvilluar mirë. Gjuha amtare dhe gjuha e dytë mund të funksionojnë si mbështetje për njëra-tjetrën. Nëse fëmija ka mësuar një koncept në gjuhën amtare, për shembull "gaajaysan" në Somalisht, është më e lehtë për të mësuar fjalën për konceptin korrespondues "sulten" në Norvegjisht.

Të gjithë prindërit duan që fëmijët e tyre të kenë sukses në shkollë. Prandaj shumë prindër dëshirojnë që fëmijët e tyre të mësojnë Norvegjisht herët. Kjo nuk do të thotë se prindërit duhet të ndalojë së përdoruri gjuhën amtare, kur ata i flasin fëmijës. Prindërit mund ti ndihmojnë fëmijët të hyjnë në situata ku ata mund të hasin gjuhën Norvegjeze. Kjo zakonisht ndodh në kopshtin e fëmijëve dhe në mjedisin vendas, ose së bashku me miqtë dhe të njohurit e prindërve.



3 CILËN GJUHË DUHET PRINDËRIT TË FLASIN ME FËMIJËN NESE ATA KANE GJUHË TË NDRYSHME AMTARE?

Në familjet ku nëna dhe babai kanë gjuhë të ndryshme amtare, është e rekomandueshme që të dy prindërit të flasin gjuhën e tyre amtare me fëmijën. Kur e gjithë familja është së bashku, mund të zgjidhni gjithçka që ndjehet e natyrshme për t'u përdorur, një nga gjuhët amtare, Norvegjishten, ose një tjetër gjuhë të përbashkët. Gjëja më e rëndësishme është që prindërit të mund të komunikojnë me fëmijën në gjuhën që prindërit zotërojnë më mirë. Gjithashtu, në familjet ku njëri nga prindërit është folës i Norvegjishtes dhe tjetri ka një gjuhë tjetër amtare, është mirë për fëmijën nëse secili prej prindërve flet ose gjuhën e tij ose të saj. Shpesh gjuha Norvegjeze mund të jetë gjuha dominuese në familje të tilla. Nëse prindërit dëshirojnë që fëmijët të jenë shumëgjuhësh, është e rëndësishme t'i japin fëmijës mbështetjen për zhvillimin e të dyja gjuhëve.



4 PO NËSE FËMIJA I PËRZJEN GJUHËT?

Është plotësisht normale që fëmijët shumëgjuhësh të përzbejnë fjalë nga gjuhë të ndryshme në një dhe të njëjtën fjalë. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se ata ende nuk kanë mësuar të bëjnë dallimin në mes të gjuhëve të ndryshme. Fëmija gjithashtu mund të "marrë hua" fjalë nga gjuha tjetër, nëse ai ka nevojë për këtë. Fëmija i përdor kompetencat e tij gjuhësore të përgjithshme në këtë mënyrë.

Është normale që një fëmijë të kalojë nga një gjuhë tek tjetra, teksa flet me njerëz të tjerë dygjuhësh. Ata janë duke shfrytëzuar mundësinë për të kaluar nga një gjuhë tek tjetra, në mënyrë që të shprehin një nuancë apo një ndjenjë, ose për të krijuar një miqësi mes njerëzve që flasin të njëjtën gjuhë. Shumë njerëz me një gjuhë mund ta kenë të vështirë të kuptojnë ose të pranojnë kalimin nga një gjuhë tek tjetra në këtë mënyrë. Hulumtimet tregojnë se një nivel i lartë i kompetencës gjuhësore është i nevojshëm për të qënë në gjendje të kalohet nga një gjuhë tek tjetra siç duhet dhe se kjo është e natyrshme dhe funksionale në biseda dygjuhëshe.

Për shkak se ne përdorim gjuhë të ndryshme në kontekste të ndryshme, është normale për fëmijët që flasin disa gjuhë të zotërojnë fusha dhe situata të ndryshme më mirë në një gjuhë sesa në tjetrën. Për shembull, fëmija mund të jetë në gjendje të shpjegojë më lehtë se çfarë ndodhi në kopësht në Norvegjisht, por preferon të përdorë gjuhën amtare, kur dëshiron të flasë për gjërat dhe situatat që kanë të bëjnë me familjen dhe shtëpinë. Fëmija mund të përdorë gjuhën amtare në bisedë me të afërmit e moshuar dhe prindërit, por kalon nga një gjuhë tek tjetra, kur flet me miqtë dhe vëllezërit e motrat.



5 ÇFARË TË BËNI NËSE FËMIJA NË SHTËPI PËRGGJIGJET VETËM NË NORVEGJISHT?

Nuk është e pazakontë për fëmijët dygjuhësh gjatë periudhave të caktuara të preferojnë të flasin Norvegjisht edhe nëse prindërit përqipen të jenë të qëndrueshëm dhe t'ju flasin atyre gjuhën e tyre amtare. Nëse fëmija flet Norvegjisht kur prindërit flasin gjuhën amtare, prindërit mund të përqipen ta ndihmojnë fëmijën duke ju përgjigjur me fjalët dhe shprehjet e sakta në gjuhën amtare. Kontakti dhe komunikimi me fëmijën, është megjithatë më i rëndësishëm, pavarësisht gjuhës së përdorur. Është më e rëndësishme të dëgjosh atë që fëmija ka për të thënë sesa të jesh shumë i shqetësuar se në cilën gjuhë ai zgjedh për ta thënë atë. Gjëja e rëndësishme është që të jeni të durueshëm. Kërkon kohë që një fëmijë të mësojë gjuhën amtare në një mjedis ku Norvegjishtja ka një ndikim të madh dhe shpesh një status më të lartë sesa gjuha amtare.

Në mënyrë që fëmija të jetë shumëgjuhësh, është e rëndësishme që prindërit të vazhdojnë të flasin gjuhën amtare me fëmijën. Do të ishte shumë mirë nëse ka fëmijë të tjerë në zonë si edhe të rritur të cilët ndajnë gjuhën amtare të fëmijës në mënyrë që gjuha të plotësojë një funksion edhe jashtë familjes. Edhe nëse fëmija flet gjuhën amtare të prindërve në mënyrë aktive, ato shpesh mund të kuptojnë shumë më tepër se sa ata mund të thonë. Kjo mund të krijojë një bazë për të mësuar përdorimin e gjuhës në mënyrë më aktive më vonë.



6 ÇFARË MUND TË BËHET PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIT TË GJUHËS AMTARE TEK FËMIJA?

Fëmijët Turqisht-folës në Turqi dhe fëmijët Norvegjisht-folës në Norvegji e mësojnë gjuhën e tyre amtare në situata të ndryshme dhe në kontakt me shumë njerëz të ndryshëm: brenda familjes së bashku me të afërmit dhe miqtë në kopshtin e fëmijëve, në shkollë, në dyqane, në rrugë dhe në autobus. Gjithë ditën fëmija ka mundësinë e dëgjimit, të folurit dhe të mësuarit e gjuhës amtare. Shumë fëmijë me një formim kulturor prej pakicash kanë mundësi të kufizuar për të zhvilluar gjuhën e tyre amtare në Norvegji. Shumica e fëmijëve para së gjithash e dëgjojnë dhe e përdorin gjuhën amtare në shtëpi. Kjo paraqet kërkesa të mëdha për prindërit të cilët së bashku me kopshtin dhe shkollën duhet të nxisin zhvillimin e gjuhës amtare të fëmijës. Të rriturit që rrethojnë fëmijën duhet të krijojnë mundësinë që fëmija të flasë gjuhën amtare sa më shumë të jetë e mundur, si brenda dhe jashtë familjes.

Shumë komuna ofrojnë kopshte të hapura ku prindërit janë të pranishëm së bashku me fëmijën. Ju mund të vini këtu për të takuar prindërit dhe fëmijët e tjerë në lojë, aktivitete dhe ndërveprim shoqëror. Në disa komuna, biblioteka ofron rrëfime të historive në gjuhë të ndryshme. Bibliotekat kanë në dispozicion libra dhe audio-libra në gjuhë të ndryshme të cilat fëmijët e të rinjtë mund ti marrin hua. Hulmtoni për të parë se çfarë mundësish janë në dispozicion në komunën tuaj. Përveç kësaj, kopshtet dhe shkollat mund të përfitojnë nga Biblioteka Shumëgjuhëshe dhe shkolla mund të përfitojë nga Biblioteka Deichman në Oslo (www.dfb.deichman.no). Librat atje janë në dispozicion si për fëmijët edhe për të rriturit në shumë gjuhë të ndryshme. Biblioteka lokale mund të ndihmojë me huamarrjen prej atje të librave. Në faqen e internetit www.morsmal.no mund të gjeni libra dhe audio-libra në gjuhë të ndryshme, si dhe vjersha, këngë dhe tregime në gjuhë të ndryshme.



7 ÇFARË MUND TË BËHET PËR MBËSHTETJEN E ZHVILLIMIN TË GJUHËS NORVEGJEZE TEK FËMIJA?

Pjesëmarrja në kopësht është një pikënisje e mirë për zhvillimin e Norvegjishtes tek fëmijët shumëgjuhësh. Për më tepër bashkëpunimi i mirë midis kopshtit, qendrës shëndetësore, shkollës dhe prindërve është i rëndësishëm. Kopshti dhe shkolla kanë një përgjegjësi të madhe për zhvillimin e gjuhës Norvegjeze tek fëmijët, por roli i prindërve mbetet ende i rëndësishëm për zhvillimin e Norvegjishtes tek fëmija. Prindërit gjithashtu mund të mbështesin punën që bëhet me gjuhën në kopësht dhe në shkollë, edhe nëse vetë prindërit nuk e flasin mirë Norvegjishten.

Tek fëmijët parashkollorë, kopshti mund të japë mundësi të mira dhe të ndryshme për zhvillimin e aftësive gjuhësore. Kur fëmija rritet dhe shkon në shkollë, kujdesi pas-shkollor (SFO) ose aktivitetet shkollore dhe interesat e ndryshëm të kohës së lirë të tilla si futboll, kori, vallja, shkolla kulturore apo të ngjashme si këto mund të jenë vende të mira takimi për zhvillimin gjuhësor dhe social. Prindërit mund t'i inkurajojnë fëmijët të marrin pjesë në këto aktivitete.

Kopshti është përgjegjës për lehtësimin e zhvillimit gjuhësor të fëmijës në kopësht, në bashkëpunim të ngushtë me prindërit. Kopshti nëpërmjet Planit Kornizë për përmbajtjen dhe detyrat e kopshtit është i detyruar të "mbështesë fëmijët në përdorimin e gjuhës së tyre amtare duke punuar në mënyrë aktive për të promovuar kompetencën gjuhësore të Norvegjishtes tek fëmija" (Ministria e Arsimit 2011: 35). Prindërit mund të diskutojnë me mësuesit e kopshteve rreth nevojave që fëmija ka për nxitjen e gjuhës dhe nëse ekziston mundësia për të pasur një asistent dygjuhësh, për shembull, ose për të siguruar ndonjë masë tjetër gjuhësore pedagogjike në kopshtin e fëmijëve.

8 PËRSE NJË FËMIJË NUK FLET NË KOPSHTIN E FËMIJËVE?

Një fëmijë që mëson një gjuhë të re krijon marrëdhënie me gjuhën e re, në mënyra të ndryshme. Disa fëmijë fillojnë të provojnë fjalë dhe fjali në gjuhën e re menjëherë, ndërsa të tjerë presin për një kohë të gjatë, ndonjëherë disa muaj para se të shprehen në gjuhën e re. Kur një fëmijë fillon të marrë pjesë në një kopësht ku gjuha amtare nuk flitet, për të mund të krijohet një situatë sfiduese. Gjatë kësaj kohe, ndërveprimi i ngushtë dhe i sigurt me të rriturit në kopshtin e fëmijëve është veçanërisht i rëndësishëm. Edhe në qoftë se fëmija nuk flet Norvegjisht me fëmijët dhe të rriturit në kopshtin e fëmijëve, është e rëndësishme të shihet nëse fëmija komunikon në mënyra të tjera, për shembull, duke treguar e duke përdorur mimikën dhe gjuhën e trupit. Fëmija mbledh njohuri dhe informacion në lidhje me gjuhën e re gjatë gjithë kohës, edhe në qoftë se ai nuk e shpreh atë në Norvegjisht. Disa fëmijë mundet që për arsye të ndryshme të kenë zhvillimin të vonuar të gjuhës apo vështirësi gjuhësore. Atëherë kopshti dhe prindërit duhet të bashkëpunojnë mbi mënyrën se si ata mund ta ndihmojnë fëmijën, për shembull, duke marrë ndihmë të jashtme për të hetuar zhvillimin gjuhësor të fëmijës dhe duke i dhënë fëmijës ndihmën shtesë të nevojshme si në shtëpi dhe në kopsht.

Edhe nëse nuk ka fëmijë ose të rritur të tjerë të cilët flasin gjuhën amtare në kopshtin e fëmijëve, është pozitive për zhvillimin shumëgjuhësor të fëmijës nëse gjuha amtare pranohet. Prindërit duhet të flasin gjuhën amtare me fëmijën, kur ata janë në kopshtin e fëmijëve – sa herë që është e natyrshme për të bënë këtë. Personeli që nuk ndan gjuhën amtare të fëmijës, duhet të tregojë një interes pozitiv në të, për shembull duke mësuar disa fjalë, këngë dhe vjersha në gjuhën amtare të fëmijës. Prania në kopësht si e të rriturve ashtu edhe fëmijëve që zotërojnë gjuhën amtare të fëmijës është gjë e mirë për zhvillimin shumëgjuhësor të fëmijës.



9 A DUHET QË FËMIJA TË MARRË NDIHMË DYGJUHËSORE NË KOPSHTIN E FËMIJËVE?

Jë numër i madh fëmijësh kanë një gjuhë amtare që nuk është Norvegjishtja dhe e mësojnë Norvegjishten si gjuhë të dytë në kopshtin e fëmijëve. Është e rëndësishme që fëmija të mirëkuptohet dhe të ketë mundësinë për tu shprehur. Kopshti duhet të mbështesë faktin se fëmija përdor gjuhën e tij amtare dhe në të njëjtën kohë në mënyrë aktive punon në ndërtimin e aftësive gjuhësore të fëmijës në Norvegjishten e folur (Plani Kornizë 2011: 35).

Gjuha amtare e fëmijës mund të mbështetet në shumë mënyra, pavarësisht nëse personeli e di gjuhën amtare të fëmijës apo jo, por për shumë fëmijë mund të jetë e rëndësishme marrja e ndihmës dygjuhësore në kopshtin e fëmijëve. Personeli dygjuhësh mund të kontribuojë në rritjen e sigurisë si për fëmijën edhe për prindërit dhe mund të funksionojë si një lidhje midis shtëpisë dhe kopshtit. Së bashku me një të rritur që e di gjuhën amtare të fëmijës, fëmija mund të kuptojë dhe ta bëjë veten të kuptohet, kur ndeshet me fëmijët dhe të rriturit e tjerë në kopshtin e fëmijëve. Fëmija merr një mundësi të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës amtare dhe në të njëjtën kohë ai ose ajo merr mbështetje për të zhvilluar aftësitë e tij në gjuhën Norvegjeze.

Të gjitha kopshtet me fëmijë që kanë prejardhjen gjuhësore të pakicave mund të aplikojnë në komunë për fondet shtetërore të rezervuara përmes Subvencioneve për masat e përmirësimit të të kuptuarit e gjuhës tek fëmijët e pakicave gjuhësore në moshën parashkollore. Fondet mundet që ndër të tjera të përdoren për të punësuar një asistent dygjuhësh i cili do të kontribuojë duke u kujdesur për zhvillimit dygjuhësor të fëmijës. Lexoni më shumë për këtë në letrën qarkore të subvencioneve shtetërore mbi kopshtin; <http://www.udir.no/Barnehage/Regelverk/Rundskriv/2011/Rundskriv-F-01-11-Statstilskudd-pa-barneha-geomradet1/>

10 KUR FËMIJA FILLON SHKOLLËN

Kalimi nga kopshti në shkollë mund të jetë madhor për shumë fëmijë – dhe prindërit. Komunat rekomandohet ti zgjedhin vetë procedurat e bashkëpunimit për këtë kalim dhe kopshti duhet të ketë plane për kalimin nga kopshti në shkollë në programin e tyre. Prindërit mund të marrin informacion në lidhje me këtë në kopësht ose nga autoritetet lokale.

Sa i përket detyrimeve të shkollës ndaj fëmijëve me një prejardhje gjuhësore të pakicave, duhet pasur veçanërisht parasysh Dekreti i Arsimit §2.8.

§2-8. Arsimi special gjuhësor për nxënësit me prejardhje gjuhësore të pakicave

Nxënësit në arsimin e detyruar të cilët kanë një gjuhë tjetër amtare nga ajo Norvegjeze dhe Sami kanë të drejtën e arsimit special në gjuhën Norvegjeze, derisa ata të jenë mjaftueshëm të aftë në gjuhën Norvegjeze për të ndjekur mësimin e zakonshëm në shkollë. Nëse është e nevojshme, nxënësi të tillë kanë të drejtën e edukimit gjuhësor në gjuhën e tyre amtare, mësimin e lëndës gjuhësore të dyfishtë ose të dyja.

Mësimi i gjuhës amtare mund të zhvillohet në një shkollë tjetër nga ai që nxënësi merr pjesë normalisht.

Kur mësimi i gjuhës amtare dhe mësimi i gjuhës së dyfishtë të subjekteve nuk mund të sigurohet nga një personel të përshtatshëm mësimor, komuna duhet që sa më shumë të jetë e mundur të bëjë të mundur mësimimdhënie tjetër duke ja përshtatur ambienteve të nxënësve.

Komuna duhet të shohë se çfarë aftësishë kanë nxënësit në gjuhën Norvegjeze përpara se të marrë vendime në lidhje me trajnimin special gjuhësor. Një studim i tillë duhet kryer gjatë shkollimit të tyre, për nxënësit të cilët marrin trajnimin special gjuhësor në përputhje me kërkesat, si bazë e vlerësimit nëse nxënësit kanë aftësi të mjaftueshme në gjuhën Norvegjeze për të ndjekur mësimin e zakonshëm në shkollë.

DISA SHPJEGIME FJALËSH

Gjuha e dytë: Gjuha që fëmija mëson në mënyrë të natyrshme nga mjedisi i tij përveç gjuhës amtare.

Gjuha e Shumicës: Gjuha që flasin shumica e njerëzve në vend. Në Norvegji gjuha e shumicës është Norvegjishtja.

Gjuha e pakicës: Gjuha e folur nga disa pjesë të popullsisë në vend. Në Norvegji ka gjuhë të lashta të tilla si Sami Lindore, Lule-Sami, gjuhët e Sami-së veriore, dhe gjuhët e pakicave kombëtare si Kven. Përveç kësaj, një pjesë e popullsisë flet gjuhët e pakicave të emigrantëve të tilla si Polonisht, Somalisht, Arabisht, Turqisht, Vietnimese, Tigriniaisht etj.

Gjuha amtare: Shumë do të thoshin se gjuha amtare është gjuha që ju mësoni të parën, gjuha që ju kuptoni më mirë apo gjuha me të cilën ju identifikoheni me shumë. Disa mund të thonë edhe se ata kanë disa gjuhë amtare, dhe se gjuhët e tyre amtare përbëhen nga gjuhë të shumta.

Shumëgjuhësia: Përdoret si një term kolektive për dygjuhësinë apo shumëgjuhësinë. Kjo do të thotë se fëmija zotëron më shumë gjuhë se sa vetëm një gjuhë amtare.

DOKUMENTET DREJTUESE SHTETËRORE

- Dekreti i Kopshtit

<http://www.lovddata.no/all/nl-20050617-064.html>

- Plani Kornizë për përmbajtjen dhe detyrat e kopshtit

<http://www.udir.no/Barnehage/Rammeplan/>

- Dekreti i Arsimit

<http://www.lovddata.no/all/nl-19980717-061.html>

BROSHURA PËRKATËSE PËR SHUMËGJUHËSINË

- Gjervan, Marit (red.) 2006:

Fletëpalosje informacioni me tema në lidhje me diversitetin gjuhësor dhe kulturor në kopshte. Ministria e Arsimit dhe Kërkimit

- Høigård, Anne; Mjør, Ingeborg dhe Hoel, Trude 2009:

Fletëpalosja informacioni me tema në lidhje me mjedisin gjuhësor dhe stimulimin e gjuhës. Ministria e Arsimit dhe Kërkimit

- Mjelve, Astrid Øygarden 2002:

"A keni dëgjuar ndonjë gjë të tillë?" Ndiha dygjuhësore në kopshtin e fëmijëve. Ministria Norvegjeze e Fëmijëve dhe Çështjeve të Familjes

- Qendra Kombëtare për trajnimin multikulturor (NAFO) 2010:

Broshura burimore - puna shumëgjuhësore në kopshtin e fëmijëve

FAQET PËRKATËSE TË INTERNETIT

Ata që do të donin këshilla dhe udhëzime në lidhje me trajnimin shumëgjuhësor në çerdhe apo në shkollë mund të konsultohen me faqen e internetit të qendrës nacionale për trajnim multikulturor (NAFO) www.hioa.no/nafo

NAFO gjithashtu drejton edhe faqen e internetit Tema gjuha amtare www.morsmal.no Ajo ka burime arsimore, libra, audio-libra, këngë dhe tregime në gjuhë të ndryshme, për kopshtin e fëmijëve dhe shkollat.

Drejtoria Norvegjeze për Arsimin dhe Aftësimin ka faqet e internetit për shkolla dhe kopshte. Ka rregullore, plane kornizë, kurrikula dhe udhëzime dokumente, etj www.udir.no

Komiteti i prindërve për shkollën fillore (FUG) dhe komitetin e prindërve për kopshtet e fëmijëve (FUB) kanë burime të internetit për prindërit me fëmijë në shkolla dhe kopshte. <http://www.fug.no/> <http://www.fubhg.no/>

Faqja e internetit Më shumë gjuhë për më shumë njerëz në Universitetin Tromsø ofron këshilla dhe informacion për familjet shumëgjuhësore. <http://site.uit.no/flerespraaktilflere/>



Qendra Kombëtare për trajnim multikulturor

Universiteti i Oslo dhe Akershus Fakulteti i

Shkencave të Aplikuara

Adresa fizike: Wergelandsveien 27

Adresa postare: PO box 4, St Olavs plass, 0130 Oslo

Telefon: +47 22 45 22 82

Faks: +47 22 45 21 05

E-mail: nafo@hioa.no

www.hioa.no/nafo